

# INSTRUMENTI HORIZONTAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQINË 2016-2019

*MBËSHETJA E REFORMAVE  
DHE KRIJIMI I KUSHTEVE PËR  
NDRYSHIME THELBËSORE:  
PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE TË  
PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË  
BASHKIMIT EVROPIAN DHE  
KËSHILLIT TË EVROPËS*

Garantin e drejtësisë

Luftën kundër krimit ekonomik

Luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen  
e të drejtave të grupeve të cenueshme

Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës



**INSTRUMENTI HORIZONTAL  
PËR BALLKANIN  
PERËNDIMOR DHE TURQINË  
2016-2019**

*MBËSHTETJA E REFORMAVE DHE  
KRIJIMI I KUSHTEVE PËR  
NDRYSHIME THELBËSORE:  
PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE TË  
PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË  
BASHKIMIT EVROPIAN DHE  
KËSHILLIT TË EVROPËS*

© 2019 Këshilli i Evropës. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Licencuar për Bashkimin Evropian sipas kushteve të caktuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, të riprodhohet apo të transmetohet, në asnjë lloj forme dhe me asnjë lloj mjeti, elektronik (CD-Rom, Internet, etj.) apo mekanik, duke përfshirë fotokopjimin, regjistrimin dhe çdo lloj sistemi për ruajtjen apo gjetjen e informacionit pa lejen paraprake me shkrim të Drejtorisë së Komunikimit (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Kopertina: Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve dhe Publikimeve (SPDP), Këshilli i Evropës

Fotografia e kopertinës: Shutterstock

© Council of Europe, November 2019

Ky dokument është hartuar duke përdorur fondet e Programit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i opinionit zyrtar të Bashkimit Evropian apo Këshillit të Evropës.

# Përmbajtja

<b>LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE</b>	<b>5</b>
<b>INSTRUMENTI HORIZONTAL: NJË MJET STRATEGJIK PËR MBËSHTETJEN E REFORMAVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQI</b>	<b>7</b>
<b>ÇËSHTJE GJITHËPËRFSHIRËSE</b>	<b>9</b>
Dimensioni Rajonal	9
Integrimi gjinor	9
Organizatet e Shoqërisë Civile	10
<b>GARANTIMI I DREJTËSISË</b>	<b>11</b>
Mbrojtja e të drejtave të njeriut për personat e ndaluar dhe të dënuar	11
Të Drejtat e Njeriut dhe Gjyqësori	14
Përmirësimi i aksesit në drejtësi, pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit	16
Forcimi i cilësisë dhe efektshmërisë së sistemeve të drejtësisë	18
<b>LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT, KRIMIT EKONOMIK DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR</b>	<b>21</b>
Lufta kundër Krimit Ekonomik	22
Forcimi i Integritetit dhe Lufta kundër Korrupsionit në Arsimin e Lartë	24
<b>NXITJA E ANTI-DISKRIMINIMIT DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË GRUPEVE VULNERABËL</b>	<b>27</b>
Parandalimi dhe lufta kundër diskriminimit në shkolla	27
Të Drejtat e Njeriut dhe Diskriminimi	30
Forcimi i mbrojtjes së pakicave kombëtare	31
Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore	33
<b>MEKANIZMI I KOORDINIMIT TË EKSPERTIZËS</b>	<b>35</b>



# Lista e shkurtimeve dhe akronimeve

---

<b>KKD</b>	Kompetencat për Kulturë Demokratike
<b>CEPEJ</b>	Komisioni Evropian për Efiçencën e Drejtësisë
<b>Konventa</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>OShC</b>	Organizatë e Shoqërisë Civile
<b>MKE</b>	Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës
<b>ECRI</b>	Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>Gjykata Evropiane</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>KKPK</b>	Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
<b>GRECO</b>	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
<b>Instrumenti Horizontal</b>	Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë
<b>LGBTI</b>	Lesbikë, Gej, Biseksuale, Transgjjinor dhe Interseks
<b>OJQ</b>	Organizatë joqeveritare





# Instrumenti Horizontal: një mjet strategjik për mbështetjen e reformave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi

<b>PROGRAMI</b>	<b>Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë</b>
<b>BUXHETI</b>	25,000,000 EUR
<b>FINANCIMI</b>	Bashkimi Evropian (80%) Këshilli i Evropës (20%)
<b>KOHËZGJATJA</b>	Maj 2016 – Maj 2019
<b>MBULIMI GJEOGRAFIK</b>	Ballkani Perëndimor dhe Turqia
<b>ZBATUAR NGA</b>	Këshilli i Evropës

Programi i Përbashkët i Instrumentit Horizontal, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe i zbatuar nga Këshilli i Evropës, është krijuar si një nismë bashkëpunimi me qëllim asistimin e përfituesve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi për përbushjen e standardeve të Këshillit të Evropës dhe, sipas rastit, zbatimin e *acquis* të Bashkimit Evropian në kuadrin e procesit të zgjerimit.

Instrumenti Horizontal ndjek një qasje dy-dimensionale:

- ▶ Bashkëpunim teknik në formën e këshillimit, ngritjes së kapaciteteve dhe llojeve të tjera të mbështetjes teknike, përshtatur sipas nevojave të secilit vend përfitues për arritjen e një përbushjeje më të madhe të standardeve evropiane.
- ▶ Një Mekanizëm për Koordinimin e Ekspertizës (MKE), përmes së cilit Këshilli i Evropës ofron ekspertizë legjislative dhe këshillim në lidhje me politikën në përgjigje të kërkesave të marra.

Që prej fillimit të Instrumentit Horizontal, janë realizuar gjithsej 36 projekte.

Instrumenti Horizontal është zbatuar si një program 3-vjeçar (maj 2016-maj 2019), duke u fokusuar specifikisht në këto tre tema:

- ▶ Garantimi i drejtësisë;
- ▶ Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimit të organizuar;



Mbyllja e konferencës rajonale të Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë Tiranë, Prill 2019

- Lufta kundër diskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve vulnerabël.

■ Përfituesit e Instrumentit Horizontal gjatë kësaj periudhe ishin Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kosova\*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.<sup>1</sup>

■ Instrumenti Horizontal mbështetet në rekomandimet e [organeve monitoruese të Këshillit të Evropës](#) në lidhje me përmirësimet e nevojshme në legjislacionin dhe në politikat e vendeve përfituese për respektimin e traktateve dhe standardeve të tjera të Organizatës. Projektet e Instrumentit Horizontal kanë pasur si synim qytetarët në përgjithësi dhe, si të tilla, kanë përfaqësuar një kontribut me vlerë për zbatimin e Strategjisë së Komisionit Evropian për një [‘Perspektivë të besueshme zgjerimi dhe për një angazhim më të madh të BE-së në Ballkanin Perëndimor’](#), sidomos në fushat e forcimit të bashkëpunimit dhe adresimit të sfidave specifike, me të cilat përballlet Ballkani Perëndimor.

■ Në fund të Fazës I të Instrumentit Horizontal u zhvillua një Konferencë Përmblyëse Rajonale më 3 prill 2019 në Tiranë, e cila mbledhi të gjithë aktorët për të shkëmbyer pikëpamjet e tyre në lidhje me rezultatet e programit. Pjesëmarrësit analizuan mësimet e nxjerra nga zbatimi i tij, perspektivat për bashkëpunim në të ardhmen dhe çfarë mund të bëhet ndryshe nga tani e tutje. Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës konfirmuan me këtë rast se nga viti 2019 deri në vitin 2022 do të vazhdojë Faza II e Instrumentit Horizontal, e cila do të mbështetet në rezultatet e Fazës I dhe do të garantojë vazhdimësinë e saj.

■ Kjo broshurë bazohet në rezultatet e zbatimit të Fazës I të Instrumentit Horizontal, si dhe në përfundimet e diskutuara në Konferencën Përmblyëse Rajonale.

\* Ky përcaktim nuk përbën asnjë paragjykim për qëndrimin në lidhje me statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

1. Përfshirja e Turqisë kufizohet në disa prej aktiviteteve rajonale.

# Çështje gjithëpërfshirëse

---

## Dimensioni Rajonal

— Gjatë zbatimit të Instrumentit Horizontal, ndërhyrjet e përshtatura sipas vendeve, kishin si qëllim t'u vinin në ndihmë Përfituesve për harmonizimin e standardeve evropiane me një fokus gradualisht më të fortë rajonal. Kjo bazohej tek kërkesat e institucioneve Përfituese që e vlerësonin atë si një vlerë të shtuar për programin.

— Gjatë zbatimit, u përfshinë aktivitete specifike për përmirësimin e rrjeteve rajonale dhe për t'u dhënë mundësi aktorëve të mësonin nga përvojat e njëritjetrit në përballimin e sfidave të ngjashme. Nismat rajonale u përqendruan posaçërisht në fusha si zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa), burgjet, krimi ekonomik, arsimi dhe anti-diskriminimi.

— Metoda e përmirësuar rajonale gjatë fazës së parë të Instrumentit Horizontal i hapi rrugën një dimensionit edhe më rajonal në kuadrin e Fazës II të programit.

## Integrimi gjinor

— Integrimi gjinor ishte pjesë e pandashme e zbatimit të Instrumentit Horizontal. Që të gjitha aktivitetet janë kryer duke pasur parasysh perspektivën e të drejtave të njeriut, me përfshirjen e parimeve të barazisë gjinore - në përputhje me [Strategjinë e Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore](#) – për të marrë parasysh të drejtat dhe nevojat specifike të grave dhe burrave. [Paketa e Instrumenteve të Këshillit të Evropës për Integrimin Gjinor në Projektet e Bashkëpunimit](#) ofroi njohuri, orientime dhe mënyra për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e ciklit të jetës së projektit.

— Gjatë zbatimit të Instrumentit Horizontal në fusha si drejtësia dhe sistemi penitenciar, vëmendje e veçantë iu kushtua hartimit të masave të fokusuar tek gratë, sa i përket aksesit në drejtësi dhe ndihmës juridike, kujdesit shëndetësor në burgje dhe programeve të risocializimit.

— U mblodhën të dhëna të detajuara në aspektin gjinor, duke përfshirë të dhënat për politikën penale në lidhje me dhunën me bazë gjinore, të cilat çuan jo vetëm në rritjen e ndërgjegjësimit rreth drejtësisë me ndjeshmëri

gjinore, por edhe në hartimin e masave për rritjen e përfaqësimit të grave në sistemin gjyqësor. Me qëllim adresimin e pabarazive të mundshme gjinore, u realizua një analizë e thelluar gjinore në lidhje me një projekt për personat e ndaluar dhe të dënuar dhe rezultatet e kësaj analize shërbyen për integrimin e mëtejshëm gjinor në këtë fushë në Fazën II të Instrumentit Horizontal, si dhe në shprehjen frymëzuese të interesit për fillimin e proceseve të ngjashme në kuadrin e projekteve të tjera në të gjitha fushat e ndërhyrjes së Instrumentit Horizontal.

## Organizatat e Shoqërisë Civile

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) janë përfshirë në të gjitha vendet Përfituese si parakusht kryesor për arritjen e një ndikimi afatgjatë në zhvillimin e qeverisjes demokratike dhe në qëndrueshmërinë e reformave.

U siguria bashkëpunimi me OSHC-të në përputhje me [Udhëzimet e Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e Organizatave të Shoqërisë Civile në aktivitetet bashkëpunuese të Këshillit të Evropës](#), dhe në përputhje me [Udhëzimet e Komisionit Evropian për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit](#).

OSHC-të u përfshinë në zbatimin e programeve rehabilituese për të burgosurit, duke u dhënë formë reformave gjyqësore, duke monitoruar shpenzimet për zgjedhje dhe duke përmirësuar raportimin e konfliktit të interesit. Përveç kësaj, OSHC-të luajtën rol të rëndësishëm, duke përfshirë edhe përmes Instrumentit Horizontal, në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe diskriminimit përmes identifikimit të sfidave ekzistuese dhe propozimit të zgjidhjeve për autoritetet publike.



Tema I:

## Garantimi i drejtësisë

*Buxheti: 12.34 milionë Euro*

*Objekti: 17 Projekte*

Projektet në këtë fushë u përqendruan tek burgjet dhe policia (duke përfshirë të drejtat e njeriut në policim, kujdesin shëndetësor në burgje dhe garancitë kundër torturës dhe keqtrajtit), standardet e të drejtave të njeriut në sistemin gjyqësor (duke u përqendruar në përmirësimin e zbatimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata Evropiane), aksesin në drejtësi, pavarësia dhe llogaridhënia e gjyqësorit (duke u përqendruar në forcimin e pavarësisë, llogaridhënies dhe profesionalizmit të sistemit gjyqësor).

### **Mbrojtja e të drejtave të njeriut për personat e ndaluar dhe të dënuar**

U ofrua mbështetje për të asistuar vendet Përfituese në procesin e harmonizimit të politikave, institucioneve dhe praktikave të tyre me rekomandimet e Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtitim Çnjerëzor, Degradues ose Ndëshkues.

## Arritjet:

---

- ▶ Forcimi i masave dhe praktikave që adresojnë keqtrajtimin në burgje dhe në ambientet e ndalimi.
- ▶ Përmirësimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor në burgje dhe në institucione të specializuara.
- ▶ Përmirësimi i rehabilitimit dhe ri-integrimit social të të burgosurve.
- ▶ Fokusi më i madh tek grupet e cënueshme dhe gratë në burgje dhe në institucione të specializuara.
- ▶ Përmirësimi i trajtimit të pacientëve në institucionet psikiatrike.
- ▶ Profesionalizimi dhe rritja e mëtejshme e kapaciteteve të burgjeve dhe policisë, duke përfshirë ato në fushën e adresimit të radikalizimit në burgje.

*“Shkëmbimi i praktikave më të mira evropiane në fushën e të drejtave të njeriut do të na japë mundësi për një performancë më të mirë të policisë, do të na ndihmojë për të adresuar me sukses problemet e ngjashme në të ardhmen dhe për të forcuar partneritetin me qytetarët.”*

**Hysni Shala, oficer policie me gradën kapiten në Policinë e Kosovës**

## Pikat kryesore:

---

- ▶ Kujdesi për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor është përmirësuar me trajnimin e punonjësve të kujdesit shëndetësor falë Manualit për shëndetin mendor dhe Strategjisë për parandalimin e vetëvrasjes (Shqipëri).
- ▶ Menaxhimi i burgjeve dhe trajtimi i të burgosurve të cënueshëm, sidomos i të miturve dhe grave, është përmirësuar me trajnimin e punonjësve në nivel specialisti në bazë të një programi të ri trajnimi gjatë punës, duke përfshirë trajnimin për leadership dhe menaxhim, si dhe trajnimin e punonjësve që punojnë me të burgosurit e mitur dhe të burgosurat gra (Shqipëri).
- ▶ Ri-integrimi social i të burgosurve dhe kthimi i tyre në një jetë ku zbatohet ligjin është përmirësuar përmes trajnimit të stafit për të zbatuar planifikime individuale të dënimeve (Shqipëri).
- ▶ Janë rritur kapacitetet për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të burgjeve, policisë dhe stafit mjekësor që punon me personat e privuar nga liria. Është përmirësuar niveli i kujdesit shëndetësor në burgje, sidomos për trajtimin e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor (Bosnje-Hercegovinë).

- ▶ Rreth 450 oficerë të burgjeve dhe efektivë policie i kanë përshtatur metodat e tyre të punës më shumë me standardet evropiane për rehabilitimin e të burgosurve se sa me ndëshkimin. (Bosnje-Hercegovinë).
- ▶ Rreth 90% e punonjësve mjekësorë dhe jomjekësorë rritën njohuritë për ofrimin e kujdesit ndaj pacientëve mjeko-ligjorë. Kjo çoi në futjen e konceptit të planit individual të trajtimit mjekësor dhe në përmirësimin e praktikave të përditshme, si praktikat e kërkesave dhe shqyrtimit të ankesave. (Bosnje-Hercegovinë).
- ▶ Është hartuar Strategjia e parë për Parandalimin e Vetëvrasjes për mbrojtjen e të burgosurve nga vetëdëmtimi, vetëvrasja dhe keqtrajtimi. 50% e të gjithë punonjësve mjekësorë të burgjeve u trajnuan në lidhje me etikën në burgje dhe me ofrimin e kujdesit shëndetësor mendor (Kosovë).
- ▶ Udhëzimet e rishikuara Administrative dhe Procedurat Operacionale Standarde ofrojnë një kuadër më të mirë për policimin që respekton të drejtat e njeriut, duke marrë parasysh standardet e Këshillit të Evropës (Kosovë).
- ▶ U realizuan programe rehabilitimi, duke u përqendruar tek anëtarët më të cenueshëm të popullatës së burgjeve - gratë, grupet e pakicave dhe të dënuarit me varësi nga droga. Në burgje u trajnuan disa grupe të burgosurish, duke u dhënë atyre mundësi më të mira për të gjetur punë në tregun lokal të punës (Mali i Zi).
- ▶ U prezantua koncepti i “sigurisë dinamike”<sup>2</sup> për nxitjen e një komunikimi dhe ndërveprimi më të mirë të punonjësve të burgjeve me të burgosurit bazuar në standarde të larta profesionale etike dhe në respektimin e të drejtave të njeriut (Maqedoni e Veriut).
- ▶ Për përmirësimin e trajtimit të grupeve specifike u hartuan modele trajtimi për të dënuarat gra, të dënuarit me burgim të përjetshëm dhe të dënuarit me burgim afatgjatë, të dënuarit e dhunshëm dhe të dënuarit për vepra penale seksuale dhe këto module u pilotuan me sukses në burgjet e përzgjedhura (Maqedoni e Veriut).
- ▶ Mbrojtja e të drejtave të njeriut në polici u forcua përmes rritjes së kapaciteteve trajnuese të policisë për tema të ndryshme që lidhen me etikën e policisë, parandalimin e keqtrajtimit dhe menaxhimin e policisë. Sot, mekanizmi i sapongritur i mbikëqyrjes së jashtme (MMJ) ofron mjetet e nevojshme për shqyrtimin e pretendimeve për shkelje të të drejtave të njeriut që rrjedhin nga veprimet e kryera nga punonjësit e Ministrisë së Punëve të Jashtme me autoritetet policore dhe policinë e burgjeve (Maqedoni e Veriut).

---

2. Siguria dinamike vë në pah nevojën për komunikimin e punonjësve të burgjeve me të burgosurit, nevojën për të pasur kontakte sistematike me të burgosurit, vendosjen e marrëdhënieve profesionale dhe përfshirjen e tyre në jetën e përditshme të të burgosurve.

- ▶ U projektuan dhe u testuan me sukses dy programe të reja për sjelljen e të dënuarve në burgjet pilot, të cilat lehtësojnë integrimin e të burgosurve në shoqëri pas daljes nga burgu (Serbi).
- ▶ Për t'u ofruar trajtim më të mirë personave me aftësi të kufizuara mendore, u hartuan plane individuale trajtimi dhe mjete për vlerësimin e rrezikut gjatë trajtimit të pacientëve me probleme psikiatrike (Serbi).
- ▶ Ministria e Shëndetësisë përgatiti një Strategji të re për Shëndetin Mendor, duke identifikuar prioritetet e nevojshme për përmirësimin e kujdesit shëndetësor mendor (Serbi).

*“Manuali i Trajnimit për oficerët e policisë për kompetencat kryesore që duhet të kenë për procedurat operacionale, si dhe Udhëzuesi për menaxhimin e të burgosurve dhe përmirësimin e të drejtave të njeriut në ambiente të mbyllura, na ndihmojnë të përballemi me sfidat dhe të ndërmarrim hapat e nevojshëm në punën tonë të përditshme, duke rritur në të njëjtën kohë besimin dhe marrëdhëniet e mira mes punonjësve të burgjeve dhe personave të dënuar.”*

**Muamer Mehić,**  
oficer trajtimi në burgun e Zenicës (Bosnje-Hercegovinë)

## Të Drejtat e Njeriut dhe Gjyqësori

Projektet e zbatuara në këtë fushë u fokusuan në asistencën e dhënë vendeve Përfutuese për harmonizimin e politikave, institucioneve dhe praktikave të tyre me Konventën, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, si dhe me opinionet e Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias).

*“Ky Projekt është një prej projekteve më të suksesshme sa i përket ndikimit dhe ndryshimeve që ka sjellë si rezultat i zbatimit të tij.”*

**Artur Metani, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit (Shqipëri)**

### Arritjet:

- ▶ Harmonizim më i mirë i legjislacionit dhe praktikave me Konventën.
- ▶ Rritja e efikasitetit të zgjidhjeve ligjore në vend për parandalimin e shkeljes së Konventës.





Lufta kundër keqtrajtimit nëpërmjet zbatimit të trajnimeve për protokollin e Stambollit, Budva, Qershor 2018

- ▶ Forcimi i kapaciteteve vendase për të zbatuar Konventën në nivel kombëtar.
- ▶ Forcimi i kapacitetit të fakulteteve dhe studentëve të drejtësisë lidhur me zbatimin e të drejtave të njeriut.

*“Cilësia e vendimeve të gjykatës është përmirësuar si në arsyetim, ashtu edhe në zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.”*

**Dragoljub Drašković,**  
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi.

## **Pikat kryesore:**

- ▶ *U mbyll çështja Manushaqe Puto e të tjerë*<sup>3</sup>. U morën masat e kërkuara për të ofruar kompensim për pronën dhe për të zbatuar vendimet gjyqësore vendase që i njohin të drejtën e kompensimit (Shqipëri).
- ▶ U ndryshua ligji për Avokatin e Shtetit, duke forcuar kapacitetin vendas për zbatimin efektiv të vendimeve të Gjykatës Evropiane (Shqipëri).
- ▶ 800 gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë fituan njohuri mbi jurisprudencën e Gjykatës Evropiane. 60% e prokurorëve dhe këshilltarëve u trajnuan në hetimin e rasteve të keqtrajtimit dhe 40% e të gjithë avokatëve të regjistruar u trajnuan për aplikimin e Konventës (Mali i Zi).

3. Përmes Instrumentit Horizontal, bashkëpunimi midis Avokatit të Shtetit të Shqipërisë dhe Departamentit të Këshillit i Evropës për Zbatimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka kontribuar në vendimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në shtator të vitit 2018, për të pasur mbikëqyrje nga afër të masave të përgjithshme të ndërmarra në çështjen *Manushaqe Puto e të tjerë*, mes të cilit Komiteti i Ministrave e vlerësoi mekanizmin e kompensimit në Shqipëri, si operacional dhe efektiv.

- ▶ U forcua dimensionimi i të drejtave të njeriut në nivel universitar, duke modifikuar programin e fakultetit të drejtësisë dhe duke shtuar përmbajtje lidhur me të drejtat e njeriut (Mali i Zi).
- ▶ U trajnuan 400 profesionistë të fushës së drejtësisë mes programeve për të drejtat e njeriut, duke përmirësuar njohuritë e tyre se si mbrohen të drejtat e pronësisë, si mbrohen gratë e prekura nga dhuna dhe e drejta për seancë dëgjimore brenda një afati të arsyeshëm, në përputhje me standardet evropiane. U hartua një udhëzues për të ndihmuar në përdorimin efektiv të vendimeve të Gjykatës Evropiane (Serbi).
- ▶ U trajnuan 230 profesionistë të fushës së drejtësisë për zbatimin e standardeve të Konventës dhe u krijua një grup i brendshëm trajnerësh me qëllim trajnimin prej tyre të profesionistëve të tjerë të kësaj fushe për transmetimin e njohurive të gjyqtarët dhe prokurorët se si të interpretojnë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane (Maqedoni e Veriut).
- ▶ *Çështja Selmani e të tjerë*<sup>4</sup> u mbyll nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, duke rezultuar në një ndryshim konkret të praktikës së Gjykatës Kushtetuese mbi seancat dëgjimore me qëllim shmangien e shkeljeve të ngjashme (Maqedoni e Veriut).

## Përmirësimi i aksesit në drejtësi, pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit

Projektet e zbatuara në këtë fushë kontribuan në përpjekjet e vendeve përfituese në forcimin e pavarësisë, llogaridhënies dhe profesionalizmit të sistemit gjyqësor në përputhje me [Planin e Veprimit të Këshillit të Evropës 2016-2021 për forcimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit](#), jurisprudencës së Gjykatës Evropiane dhe lehtësimin e zbatimit të rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) dhe Komisionit të Venecias.

### Arritjet:

- ▶ Forcimi i aftësive të Këshillave Gjyqësorë dhe Prokurorisë për shqyrtimin e çështjeve etike.
- ▶ Rritja e kapaciteteve të ofruesve të ndihmës juridike falas, duke përfshirë personelin e Ministrisë së Drejtësisë, organizatave jo-qeveritare (OJQ) për trajtimin me profesionalizëm të kërkesave për ndihmë juridike falas për të përmirësuar në këtë mënyrë aksesin në drejtësi.

4. Mbështetja e Instrumentit Horizontal rezultoi në lehtësimin e mbylljes së çështjes *Selmani e të tjerë*, ku Gjykata Kushtetuese vendosi të ndryshojë praktikën dhe interpretimin e Rregullave të saj lidhur me mbajtjen e seancave dëgjimore me qëllim parandalimin e shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



Akademia Rajonale Dimërore për të Drejtat e Njeriut për studentët e fakulteteve të drejtësisë, Šabac, Mars 2019

- ▶ Forcimi i garancive për gjyqë të pavarura dhe të paanshme duke zhvilluar mjetet për mbrojtjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga presioni i papërshtatshëm dhe forcimi i një kulture profesionale të paanshmërisë.

*“Njohuritë që prokurorët përfituan nëpërmjet këtyre veprimtarive janë të rëndësishme dhe trajnimi i përshtatur sipas nevojave ka forcuar ndjeshëm kapacitetet tona.”*

**Gordana Janicjević, Zëvendësprokurore e Republikës së Serbisë**

## **Pikat kryesore:**

---

- ▶ Është rritur pavarësia dhe llogaridhënia nëpërmjet vlerësimit profesional të gjyqtarëve (41 gjyqtarë të vlerësuar dhe 13 gjyqtarë të ngritur në detyrë) në kuadrin e sistemit të ri të transparencës (Mali i Zi).
- ▶ Miratimi i Kodit të Etikës për Prokurorët u pasua nga futja e metodave të reja të punës nga Komitetet Etnike të Këshillave Gjyqësore e të Prokurorisë (Mali i Zi).
- ▶ U hartua një program trajnimi dhe materialet përkatëse, të cilat mbulonin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u marrë me kërkuesit e ndihmës juridike falas, duke përfshirë modulet mbi ndërgjegjësimin gjinor dhe nevojat e posaçme të grupeve të prekshme (Maqedoni e Veriut).
- ▶ U organizua trajnimi i parë profesional për 51 përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, duke përfshirë pothuajse 100% të personelit që punon në zyrat rajonale si dhe përfaqësuesit e OJQ-ve të regjistruara dhe Dhomës së Avokatisë (Maqedoni e Veriut).
- ▶ Pas rekomandimit të GRECO-s, 100 gjyqtarë dhe 200 prokurorë u trajnuan për identifikimin, raportimin dhe reagimin më të mirë nën presione

të panevojshme, në përpjekje për të rritur besimin publik në sistemin gjyqësor (Serbi).

- ▶ U organizua një modul i posaçëm për gjyqtaret dhe prokuroret gra që kanë qenë objekt i presioneve të panevojshme, për të tërhequr vëmendjen ndaj çështjeve të barazisë gjinore dhe ngacmimeve brenda prokurorisë dhe në kontekstin e hetimeve (Serbi).

## **Forcimi i cilësisë dhe efektshmërisë së sistemeve të drejtësisë**

Projektet e zbatuara në këtë fushë kontribuuan në zbatimin e aspekteve kyçe të reformave gjyqësore duke përdorur mjetet dhe metodologjinë e Komisionit Evropian për Efektshmërinë e Drejtësisë (CEPEJ) në nivel institucional dhe gjyqësor.

### **Arritjet:**

- ▶ Progres në krijimin e një metodologjie të njëtrajtshme brenda gjyqësorit për mbledhjen e statistikave gjyqësore duke përdorur standardet e CEPEJ në gjykata dhe këshillat gjyqësore.
- ▶ Përmirësimi i njohurive për funksionimin e sistemeve të drejtësisë me statistika më të mira për politikëbërje të shëndoshë.
- ▶ Forcimi i masave për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të rasteve dhe përdorimit të përgjithshëm të Drejtësisë Kibernetike.
- ▶ Forcimi i masave të përdorura nga institucionet gjyqësore për të trajtuar reformat (hartën gjyqësore, përdorimin e përmirësuar të IT-së, etj.) dhe për përmirësimin e kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës.

*“Projekti KoSEJ siguroi të dhënat më të sakta deri më tani lidhur me gjyqësorin dhe prandaj roli i këtij projekti është jetik për punën e ardhshme të Ministrisë.”*

**Tea Blakaj, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (Kosovë)**

### **Pikat kryesore:**

- ▶ Përfituesit dhe partnerët, duke përfshirë shoqërinë civile, i kuptojnë dhe i përdorin treguesit dhe metodologjinë e CEPEJ për të mbledhur e për të analizuar statistika të besueshme e të posaçme, për të identifikuar problemet dhe për të vendosur zgjidhje afatgjata (Kosovë, Shqipëri).
- ▶ Analiza e thelluar e funksionimit të sistemit gjyqësor bazuar në statistikat më të fundit dhe të besueshme identifikoi të metat dhe rezultoi në



Prezantimi i raportit të vlerësimit të dytë mbi systemin gjyqësor në Kosovë, Prishtinë, Mars 2019

rekomandime që u përdorën si një bazë solide për reformat e sektorit të drejtësisë (Kosovë).

- ▶ U shkëmbyen praktikat relevante evropiane në mbështetje të zhvillimit të sistemeve të menaxhimit të çështjeve (Shqipëri, Kosovë).
- ▶ Kryetarët dhe punonjësit e gjykatave u trajnuan për të kuptuar më konkretisht rolin e tyre në menaxhimin e gjykatave (Kosovë, Shqipëri).
- ▶ Kapacitete më të mira të gjykatave për të përdorur mjetet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të gjykatave, veçanërisht sondazheve (Shqipëri).
- ▶ Rritje e kapaciteteve të medias dhe gjyqësorit për të komunikuar dhe për të rritur besimin e publikut (Shqipëri).

*“Raportet mbi skemën e re të vlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët më ndihmojnë në punën e përditshme, për të përcaktuar treguesit e vlerësimit të ecurisë dhe për të kryer mbi atë bazë vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.”*

**Brikena Ukperaj, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor në Shqipëri**





*Trajnim për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e pastrimit të parave, Durrës, Shkurt 2019*

## Tema II

# Lufta kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimit të organizuar

***Buxheti: 4.01 milionë Euro***  
***Objekti: 6 Projekte***

Instrumenti Horizontal në tre Vendet Përfituese (Shqipëri, Mali i Zi dhe Maqedoni e Veriut) u përqendrua te lufta kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në të cilin përfshihen, në veçanti, masat për adresimin e transparencës në financimin e partive politike, sistemet e deklarimit të pasurive, vlerësimet kombëtare të riskut dhe ngritja e kapaciteteve të njësive të inteligjencës financiare.

Përveç kësaj, në të tre vendet Përfituese (Kosovë, Mal i Zi dhe Maqedoni e Veriut) u zbatuan projekte të posaçme për të mbështetur autoritetet në ruajtjen e kuadrit të integritetit në sistemin e arsimit të lartë dhe për të parandaluar korrupsionin në arsim.

*“Instrumenti Horizontal është vërtet për popullin – drejtësi do të thotë që qytetarët të mund të ndjehen të sigurt se sistemi i tyre ligjor do t’i mbrojë ata me efektshmëri kundër padrejtësisë dhe abuzimit. Mungesa e korrupsionit dhe krimet ekonomik do të thotë se më shumë burime do të jenë në dispozicion të shtetasve për shërbime thelbësore.”*

**Deklaratë nga Liselotte Isaksson, Shefe Sektori, Drejtorja e Përgjithshme për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit (DG NEAR), Komisioni Evropian, në përfundimet e saj në Konferencën Rajonale të Mbylljes.**

## **Lufta kundër Krimet Ekonomik**

Projektet në këtë fushë mbështetën autoritetet në zbatimin e masave për parandalimin dhe hetimin e korrupsionit dhe pastrimit të parave, duke adresuar mangësitë e identifikuar në vlerësimet nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit e Terrorizmit dhe GRECO-s.

### **Arritjet:**

- ▶ Forcimi i kuadrit legjislativ për deklarimin e pasurive, financimin e partive politike dhe pastrimin e parave.
- ▶ Përmirësimi i kuadrit të integritetit për gjyqësorin, policinë dhe deputetët nëpërmjet hartimit të udhëzimeve etike dhe Kodit të Etikës/Udhëzimeve për Anëtarët e Parlamentit.



*Themelimi i sistemit elektronik për deklarimin e aseteve në Shqipëri, Tiranë, Prill 2019*



- ▶ Ndërmarrja e hapave drejt sistemeve të rikuperimit dhe menaxhimit të aseteve.
- ▶ Forcimi i aftësive të administratave publike dhe agjencive anti-korrupsion për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin.
- ▶ Bazat e përcaktuara për masa më të efektshme për të luftuar pastrimin e ardhurave nga krimi dhe financimin e veprimtarive terroriste nga autoritetet kombëtare të inteligjencës financiare.
- ▶ Forcimi i kapaciteteve të autoriteteve për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

*“Në kuadrin e Instrumentit Horizontal dhe me asistencën e Këshillit të Evropës, ne kemi krijuar një Regjistër të Pronësisë Përfituese, i cili do të na ndihmojë vërtet në vlerësimin e rrezikut, verifikimin e pronësisë së të dhënave të pronësisë dhe në shkëmbimet e dobishme me vendet fqinje të interesuara për të arritur qëllimet tona të përbashkëta.”*

**Blažo Trendafilov,**

**Kreu i Zyrës së Inteligjencës Financiare (Maqedoni e Veriut)**

## **Pikat kryesore:**

---

- ▶ Ligji për financimin e partive politike dhe Kodi Penal u ndryshuan, duke marrë parasysh rekomandimet e Këshillit të Evropës, ndërkohë që Kryeministri nxori një urdhër që ndalon përdorimin e burimeve shtetërore nga partitë politike në fushata zgjedhore për qëllime partiake (Shqipëri).
- ▶ U forcuan kapacitetet e agjencive të zbatimit të ligjit për të luftuar pastrimin e parave dhe korrupsionin nëpërmjet udhëzimeve praktike, seminareve dhe trajnimeve për gjurmimin e pasurive dhe konfiskimin (Shqipëri).
- ▶ Në përputhje me këshillimin nga Projekti kundër Krimit Ekonomik, u ngrit një njësi e posaçme mbikëqyrjeje në Komisionin Qendror Zgjedhor me qëllim rritjen e kapaciteteve të tij për të mbikëqyrur financimin e fushatave zgjedhore (Shqipëri).
- ▶ Përparim u arrit në parandalimin e konfliktit të interesit dhe garantimin e aplikimit të standardeve etike nga parlamenti, gjyqësori dhe policia. U miratuan disa udhëzime etike lidhur me tre grupe të synuara (Mal i Zi).
- ▶ U nënshkrua një memorandum mirëkuptimi midis Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Institucionit të Kontrollit të Shtetit që çoi në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht sa i

përket kontrollit të financimit të njësive politike dhe fushatave zgjedhore (Mal i Zi).

- ▶ Gjyqtarët dhe policët fituan njohuri dhe aftësi të specializuara nëpërmjet trajnimit të kushtuar zbatimit të mbrojtjes së sinjalizuesve në procedimet civile e penale (Mal i Zi).
- ▶ Në kuadër të një qasje të re në drejtim të luftës kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit, u përgatit një strategji dhe një plan veprimi kundër pastrimit të parave, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira (Maqedoni e Veriut).
- ▶ Progres u arrit me krijimin e Regjistrisë së Pronësisë Përfituese me qëllim regjistrimin e pronarëve të ligjshëm për të ditur se kush e zotëron apo kontrollon një pronë të caktuar. Paralelisht, aktorëve iu vunë në dispozicion udhëzime për sektorin privat me qëllim rritjen e transparencës dhe lehtësimin e aksesit në informacion (Maqedoni e Veriut).
- ▶ Veprimtaritë rajonale plotësuan përpjekjet e vendeve Përfituese për forcimin e një mirëkuptimi të përbashkët të standardeve dhe praktikave krahasuese për të identifikuar rreziqet e financimit terrorist dhe për të pasur një mbikëqyrje efektive të organizatave jofitimprurëse. Kjo ndihmoi në transferimin e praktikave të mira nga një Përfitues te tjetri. Të gjithë Përfituesit, duke përfshirë edhe Turqinë, morën pjesë në veprimtaritë rajonale.

## **Forcimi i Integritetit dhe Lufta kundër Korrupsionit në Arsimin e Lartë**

Projektet në këtë fushë ofruan asistencë për përpjekjet kombëtare dhe rajonale për hartimin dhe/ose forcimin e politikave anti-korrupsion dhe kuadrin e integritetit në arsimin e lartë, në përputhje me Rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për sigurimin e një arsimi cilësor, si dhe bazën e njohurive mbi Platformën mbarë-evropiane të Këshillit të Evropës për Etikën, Transparencën dhe Integritetin në Arsim (ETINED).

### **Arritjet:**

- ▶ Përmirësimi i kuadrit të integritetit për parandalimin e korrupsionit në arsimin e lartë.
- ▶ Krijimi i një kuadri legjislativ novator për mbrojtjen e integritetit akademik.
- ▶ Rritja e ndërgjegjësimit për përfitimet prej standardeve të integritetit dhe etikës mes aktorëve kryesorë në arsim, duke përfshirë edhe studentët, stafin akademik dhe menaxhimin administrativ.



Seminari “Integriteti në edukimin e lartë – sfida për administrimin e universitetit”, Budva, Dhjetor 2018

*“Si përfaqësues i një OSHC-je, mund të them se me këtë projekt kemi demonstruar se institucionet dhe sistemi mund të bashkohen forcat dhe të punojnë së bashku efektivisht.”*

**Zoran Vujičić, përfaqësues i OJQ-së Aleanca Qytetare (Mal i Zi)**

## **Pikat kryesore:**

---

- ▶ U hartuan kode model të etikës për studentët, stafin akademik dhe nivelin drejtues të universiteteve dhe u paraqitën në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Ato u miratuan edhe nga universitetet publike (Kosovë).
- ▶ U organizuan konferenca dhe debate publike në universitete, të shoqëruara me materiale dixhitale dhe kurse praktike me materiale promocionale në internet për studentët (Kosovë, Mal i Zi, Serbi).
- ▶ U hartua një ligj për Integritetin Akademik me qëllim adresimin e formave të ndryshme të shkeljeve akademike, duke përfshirë plagjiaturën dhe sjelljen joetike, si dhe futjen e standardeve minimale për mbrojtjen e integritetit akademik në institucionet e arsimit të lartë, të cilat u miratuan në muajin Mars 2019 (Mal i Zi).
- ▶ U hartua një paketë burimesh për integritetin, etikën dhe transparencën për institucionet e arsimit të lartë si një kurs i posaçëm për studentët e diplomuar dhe ata pasuniversitarë (Serbi).
- ▶ Kurse online mbi integritetin akademik (të detyrueshme për studentët e vitit të parë) si për studentët, ashtu edhe për personelin mësimdhënës në Universitetin e Malit të Zi





*Shënimi i Ditës kundër Bullizmit në Shqipëri, Nëntor 2018*

## Tema III

# Nxitja e anti-diskriminimit dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve vulnerabël

*Buxheti: 5.53 milionë Euro*

*Objekti: 13 projekte specifike*

U ofrua mbështetje për adresimin e racizmit, ngacmimit, segregimit dhe ekstremizmit në sistemin e arsimit, për të mbështetur punën e Avokatit të Popullit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (me fokus të veçantë në ndihmën për viktimat e trafikimit), si dhe kundër formave të ndryshme të diskriminimit siç janë diskriminimi ndaj pakicave kombëtare, si dhe diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor.

### **Parandalimi dhe lufta kundër diskriminimit në shkolla**

Projektet në këtë fushë u ofruan ndihmë autoriteteve veçanërisht në zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (këtë j tutje: KKKPK) dhe Komisionerit për të Drejtat e Njeriut.

## Arritjet:

---

- ▶ Kontribut në politikat e bazuara në prova në arsim në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe barazisë.
- ▶ U morën masa të posaçme kundër diskriminimit, duke përfshirë strategjitë dhe reagimet ndaj bullizmit në shkolla pilot dhe u integruan më pas në nivel kombëtar.
- ▶ Forcimi i kapaciteteve të shkollave pilot në nxitjen e një kulture demokratike në shkolla në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe barazisë.
- ▶ Në disa shkolla private pilot u prezantua Kuadri i Këshillit të Evropës për Kompetencat e Kulturës Demokratike (CDC).

*“Klima midis studentëve dhe mësuesve ka ndryshuar, ajo është bërë më miqësore dhe më bashkëpunuese. Prindërit dhe komuniteti janë bërë më aktivë në jetën e shkollës. Kjo i ndihmon studentët të përfshihen në veprimtari (kundër bullizmit). Ka ndryshuar mënyra si e shohim këtë fenomen”*

**Punonjës social në Shqipëri**

## Pikat kryesore:

---

- ▶ Rekomandimet mbi bullizmin në shkolla u integruan në Ligjin e ri mbi të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës si dhe në “Axhendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017-2020” dhe 21 Nëntori u shpall Dita Kombëtare kundër Bullizmit në Shkollë. Mbi 14,000 qytetarë dhe të rinj u arritën nëpërmjet këtyre veprimtarive (Shqipëri).
- ▶ Programi i Trajnimit të Mësuesve për reduktimin e bullizmit u akreditua nga Komisioni për Akreditimin e Moduleve të Trajnimit dhe Programeve për periudhën 2017-2021, pas pilotimit të tij me 210 mësues nga 21 shkolla pilote (Shqipëri).
- ▶ Këto praktika pilote kundër bullizmit do të integrohen në të gjitha shkollat pas daljes së një Udhëzimi të Përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vitin shkollor 2019-2020 (Shqipëri).
- ▶ Rekomandimet në nivel politikash dhe një Udhërrëfyes për promovimin e arsimit cilësor në Shoqëritë Multi-Etnike në BH u miratuan nga të gjitha ministrinë përgjegjëse të arsimit dhe në bazë të një studimi vlerësimi, u krijuan fokus grupe dhe mbështetje për zbatimin e masave për adresimin



*Trajnim dhe shkëmbime mes profesionistëve për 40 anëtarë të shkollave pilote Serbe, Budapest, Korrik 2018*

e segregimit etnik në sistemin formal të arsimit në nëntë shkolla pilot. (Bosnje-Hercegovinë).

- ▶ U hartua një program trajnimi për mësuesit në shërbim (fokusuar te profesionistët e fushës së arsimit në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar), i cili është tashmë gati t'i nënshtrohet procesit kombëtar të akreditimit (Mal i Zi).
- ▶ Udhërrëfyes për nxitjen e një kulture demokratike në shkolla për informimin dhe orientimin e politikëbërësve për mënyrën e nxitjes së kulturës demokratike në nivel programimi, nivel pedagogjik, dhe në edukimin e mësuesve për një qasje të re të shkollës (Mal i Zi).
- ▶ 1000 mësues, drejtorë shkolle, psikologë dhe përfaqësues të komunitetit nga 20 shkolla pilote u trajnuan për të drejtat e njeriut, bullizmin dhe dhunën në shkolla, përfshirjen sociale dhe integrimin gjinor në arsim. Përveç kësaj, 26 prilli u shpall zyrtarisht "Dita e Diversitetit dhe Përfshirjes". (Kosovë).
- ▶ U miratua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Udhërrëfyesi, duke përfshirë rekomandimet për politika që mbështesin kulturën demokratike në shkolla dhe respektin për diversitetin (Kosovë).
- ▶ 26 shkolla pilot, 1,000 profesionistë të fushës së arsimit dhe mbi 10,000 anëtarë të komuniteteve u përfshinë në organizimin e 11 Tetorit si "Dita Kombëtare e Gjithëpërfshirjes". Përveç kësaj, 200 mësues morën pjesë në një trajnim të certifikuar për mënyrën e shpjegimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe për të përfutur njohuri që prekin të gjitha veprimtaritë jashtë programit të shkollës (Mal i Zi).

- ▶ Kuadri i Këshillit të Evropës për Kompetencat për Kulturë Demokratike u miratua dhe u integrua plotësisht në veprimtaritë e mësimdhënies dhe në programet jashtëshkollore në 20 shkolla pilot dhe rekomandimet për shtrirjen e tyre u miratuan nga Ministria e Arsimit. 2150 studentë dhe 250 mësues u përfshinë në rishikimin e standardeve të arsimit cilësor në lidhje me edukimin demokratik (Serbi).
- ▶ U përgatitën udhëzime për përfaqësimin e duhur të pakicave kombëtare në programet e detyrueshme, standardet dhe tekstet për shkollat fillore e të mesme, duke u mbështetur në ekspertizën e Këshillit të Evropës (Serbi).
- ▶ Vëmendje e paprecedent që arriti të paktën 100,000 shtetas në të gjitha pjesët e Serbisë, duke përfshirë pakicat kombëtare, duke qenë se raportet botohen edhe në gjuhët e pakicave (Serbi).

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik është jashtëzakonisht e kënaqur me rezultatet e këtij projekti, kështu që po mendojmë se si mund të vazhdojë.*

**Anamarija Viček,**  
Sekretare e Shtetit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës  
dhe Zhvillimit Teknologjik të Serbisë

## Të Drejtat e Njeriut dhe Diskriminimi

Projektet e zbatuara në këtë fushë u përqendruan në ndihmën e ofruar Përfituesve në harmonizimin e mëtejshëm të politikave dhe praktikave të tyre në përputhje me Konventën dhe me rekomandimet e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut dhe ECRI-n.

### Arritjet:

- ▶ Forcimi i Institucionit të Avokatit të të Drejtave të Njeriut për të luftuar diskriminimin.
- ▶ Progres i arritur në zbatimin e rekomandimeve të ECRI-t nëpërmjet trajnimit të synuar në parandalimin e diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

*“Kjo ishte hera e parë që avokatët qenë një objektiv i drejtpërdrejtë i veprimtarive dhe aftësitë tona analitike kanë kontribuar në cilësinë e çështjeve të shumta lidhur me rastet e diskriminimit.”*

**Avokat nga Institucioni i Avokatit të të Drejtave të Njeriut nga Bosnje-Hercegovina**



## Pikat kryesore:

---

- ▶ Për parandalimin dhe luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, u krijua një ekip ndërmintor për mbikëqyrjen e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat Lesbike, Gej, Biseksualë, Transgjinorë dhe Interseks (LGBTI) dhe mbi 150 policë u trajnuan për identifikimin dhe trajnimin në lidhje me krimet e urrejtjes ndaj personave LGBTI (Shqipëri).
- ▶ U hartua një udhëzues mbi “Policimin e Krimeve të Urrejtjes kundër personave LGBTI: Trajnim për një Reagim Profesional Policor”, i cili u integrua në programin e Akademisë së Sigurisë për trajnimin e efektivëve të policisë në shërbim (Shqipëri).
- ▶ U forcuan kapacitetet e Institucionit të Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin. U prodhua një manual kundër diskriminimit dhe u prezantua një mekanizëm për mbledhjen e të dhënave (Bosnje-Hercegovinë).
- ▶ U forcua dialogu midis Institucioneve të Avokatit të Popullit dhe 43 institucioneve publike në nivel qendror, rajonal e bashkiak, si dhe u vendosën lidhje më të ngushta me gjyqësorin, për të rritur cilësinë e gjykimeve në vend (Bosnje-Hercegovinë).
- ▶ U forcua bashkëpunimi midis Institucioneve të Avokatit të Popullit, Agjencisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Qendrave Gjinore të Federatës së Bosnje-Hercegovinës dhe Republikës Srbska për të luftuar më mirë dhunën me bazë gjinore (Bosnje-Hercegovinë).

## Forcimi i mbrojtjes së pakicave kombëtare

Projektet u përqendruan në dhënien e asistencës në zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut si edhe në ato që dalin nga mbikëqyrja e Konventës Kornizë për Pakicat Kombëtare (KKPK) dhe Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale apo të Pakicave.

## Arritjet:

---

- ▶ Forcimi i kapaciteteve të institucioneve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e personave që u përkasin pakicave kombëtare.
- ▶ Përmirësimi i kuadrit ligjor për të mbrojtur të drejtat e pakicave kombëtare.
- ▶ Përmirësimi i dialogut ndërkulturor dhe bashkërendimit institucional midis aktorëve të duhur.



Konkursi i parë i shkollave fillore mbi minoritetet kombëtare në Bosnjë Hercegovinë, Shkurt 2019

*“Ky Projekt ka kontribuar vërtet, duke i vënë në pozita më të mira pakicat kombëtare në Bosnje- Hercegovinë. Ne jemi dëshmitarë të rritjes së kapaciteteve të organeve që përfaqësojnë pakicat, komunikimit më të mirë midis Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve dhe OSHC-ve në terren, dhe një perspektive të ndryshme që media ka ndërmarrë kur është fjala për pakicat kombëtare në Bosnje-Hercegovinë.”*

**Tihomir Knežiček,**  
anëtar i Këshillit Kombëtar të Pakicave  
Kombëtare të Bosnje-Hercegovinës.

## **Pikat kryesore:**

- ▶ U miratua Ligji Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, i cili hoqi diferencimin midis pakicave kombëtare dhe komuniteteve etno-gjuhësore dhe njohu nëntë pakica kombëtare dhe parimin e vetë-identifikimit (Shqipëri).
- ▶ Nën kujdesin e Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve u ngrit një Grup për Koordinimin e Pakicave si forumi i parë zyrtar për përmirësimin e dialogut mes pakicave dhe autoriteteve (Bosnje-Hercegovinë).
- ▶ U mbështetën pesë njësi të vetëqeverisje lokale (Brcko, Prijedor, Prnjavor, Sarajevo dhe Tuzla) nëpërmjet granteve të vogla për promovimin e kulturave, gjuhëve, traditave dhe pakicave, si dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën publike (Bosnje-Hercegovinë).

- ▶ U ndryshua Ligji për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare në përputhje me rekomandimet e KKKP-së (Serbi).
- ▶ U përgatitën udhëzime për përdorimin e gjuhëve të pakicave në arsim, administratë dhe gjyqësor (Serbi).
- ▶ U mbështetën pesë njësi të vetëqeverisjes lokale (Bosilegrad, Bujanovac, Medvedja, Sombor dhe Vranje) me grante të vogla për të nxitur gjuhët e pakicave në arsim, administratë dhe sistem gjyqësor, duke përfshirë nxitjen e trashëgimisë gjuhësore dhe identitetit dhe vendosjen e shenjave topografike dy-gjuhëshe (Serbi).

## Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qënieve njerëzore

Projektet u përqendruan në dhënien e asistencës në zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore.

### Arritjet:

- ▶ Forcimi i aftësive të inspektorateve të punës dhe aktorëve kryesorë kundër trafikimit për parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit të punës.
- ▶ Progresi në rritjen e aksesit në kompensimin e viktimave të trafikimit.

*“Ky projekt përbën një punë të re në parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qënieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit të punës në Serbi, duke qenë se inspektorët e punës dhe të tregut kanë qenë më parë të përfshirë dhe nuk janë trajnuar për këtë çështje.”*

**Mitar Djuraskovic, Koordinator Kombëtar kundër Trafikimit (Serbi).**

### Pikat kryesore:

- ▶ 60% e inspektorëve të punës në Serbi dhe 90% në Maqedoninë e Veriut u trajnuan për çështjet e trafikimit të qënieve njerëzore (Maqedoni e Veriut dhe Serbi).
- ▶ Arritja e një bashkëpunimi më të fortë mes aktorëve kryesorë kundër trafikimit dhe mes vendeve të destinacionit të viktimave/vendeve të origjinës së viktimave në mënyrë që të sigurohet mbrojtje më e mirë për të drejtat e viktimave të trafikimit në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi.



Seminar mbi indikatorët në dedektimin dhe identifikimin paraprak të fëmijëve viktime të trafikimit, Shkup, Shkurt 2019.

- ▶ Progres në hartimin e legjislacionit që siguron mundësinë e një fondi shtetëror kompensimi për viktimat e krimeve, duke përfshirë viktimat e trafikimit (Maqedoni e Veriut).
- ▶ Rritja e mirëkuptimit të profesionistëve ligjorë dhe aktorëve të tjerë kryesorë kundër trafikimit për mënyrat e garantimit të aksesit viktimave në kompensim (Maqedoni e Veriut dhe Serbi).

*“Profesionalisht, pjesëmarrja në këtë projekt është shumë e rëndësishme për mua, sepse më ka dhënë mundësi të përmirësoj njohuritë dhe aftësitë në fushën e luftës kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Tani kam një qasje tjetër që do të ma bëjë punën më efektive”*

**Fatime Bytyqi, Inspektorati Shtetëror i Punës (Maqedoni e Veriut).**



*Një delegacion i Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR viziton Shqipërinë, Tiranë, Shtator 2018*

## Mekanizmi i Koordinimit të Ekspertizës

U ofrua këshillim dhe ekspertizë mbi baza ad-hoc në kuadrin e Mekanizmit të Koordinimit të Ekspertizës (MKE) në përgjigje të kërkesave për analizim të legjislacionit dhe ndihmë lidhur me të. Organet dhe departamentet e Këshillit të Evropës ofruan ekspertizë legjislativë dhe këshillim në nivel politikash në përgjigje të kërkesave specifike në fusha si: garantimi i drejtësisë, lufta ndaj krimit ekonomik, parandalimi i diskriminimit, mbrojtja e të drejtave të grupeve të prekshme, liria e shprehjes dhe e medias, si dhe çështjet kushtetuese në fushën e kompetencave të Komisionit të Venecias.

Në tre vitet e zbatimit, u paraqitën gjithsej 21 kërkesa, nga të cilat 14 iu referuan për ekspertizë Komisionit të Venecias dhe 7 njërive të tjera të Këshillit të Evropës, duke përfshirë Zyrën e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Migracionin.

Arritjet kryesore përfshijnë:

- ▶ Në sesionin e vet plenar më 14-15 tetor 2016, Komisioni i Venecias miratoi një *amicus curiae* mbi Ligjin për Trajtimin e Pronës dhe Finalizimin e Procesit të Kompensimit të Pronës.

- ▶ Në sesionin e vet plenar më 14-15 tetor 2016, Komisioni i Venecias miratoi një amicus curiae për metodën e zgjedhjeve në Dhomën e Popujve të Federatës së Bosnje-Hercegovinës, në përgjigje të një kërkesë nga Gjykata Kushtetuese e Bosnje-Hercegovinës.
- ▶ Në sesionin e vet plenar më 9-10 dhjetor 2016, Komisioni i Venecias miratoi një amicus curiae mbi ligjin për rivlerësimin kalimtar (ose 'vetingun') të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri në përgjigje të një kërkesë nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë.
- ▶ Pas kërkesës nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor nga Maqedonia e Veriut, në mars 2017, një ekspert nga Komisioni i Venecias u dërgua për të dhënë asistencë për administrimin e zgjedhjeve lokale.
- ▶ Në Malin e Zi u miratua Ligji për të Huajt në përputhje me rekomandimet e bëra nga Zyra e Këshillit të Evropës të Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Çështjet e Migracionit, gjë që përbën një ecuri pozitive në mbrojtjen e përgjithshme të të drejtave të emigrantëve në Malin e Zi.
- ▶ Në sesionin e vet plenar më 16-17 mars 2018, Komisioni i Venecias miratoi Opinionin mbi Projektligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen kundër Diskriminimit në Maqedoninë e Veriut.
- ▶ U ofrua ekspertizë ligjore dhe këshillim në nivel politikash për institucionet gjyqësore kryesore në Maqedoninë e Veriut, duke përfshirë Këshillin Gjyqësor, Këshillin e Prokurorisë dhe Gjykatën e Lartë me qëllim çuarjen përpara të proceseve të reformave në fushën e gjyqësorit.
- ▶ Pas ndihmës së dhënë gjatë procesit të hartimit të ndryshimeve në Kushtetutën e Serbisë lidhur me gjyqësorin, Opinioni i Komisionit të Venecias mbi ndryshimet e propozuara u miratua në sesionin plenar të Komisionit të Venecias më 22-23 qershor 2018.
- ▶ Opinioni i Komisionit të Venecias për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Gjyqtarët në Malin e Zi, lidhur me emërimin e anëtarëve jo-gjyqtarë të Këshillit Gjyqësor u miratua në seancën plenare të Komisionit të Venecias më 22-23 qershor 2018 si një reagim urgjent ndaj rrezikut të përgjithshëm të paralizimit të degës së gjyqësorit në Mal të Zi.
- ▶ Opinioni i Komisionit të Venecias mbi projektligjin për ndryshime dhe shtesa në ligjin për financimin e partive politike në Kosovë u miratua në sesionin plenar të Komisionit të Venecias më 22-23 qershor 2018.
- ▶ Hapa u morën nga autoritetet në Malin e Zi për të përmirësuar legjislativonin e medias. MKE-ja mbështeti hartimin e tre ligjeve të reja

për median. Këto projektligje, siç janë për momentin, duket se pasqyrojnë shumë prej rekomandimeve të Këshillit të Evropës.

- ▶ Në sesionin e vet plenar më 15-16 mars 2019, Komisioni i Venecias miratoi një opinion ligjor për ndryshimet në Ligjin për Gjykatat, përgatitur nga Ministria e Drejtësisë e Maqedonisë së Veriut. Pas opinionit të Komisionit të Venecias, Maqedonia e Veriut miratoi ligjin e ndryshuar për Këshillin Gjyqësor. Shqetësimet kryesore të shprehura në këtë opinion u adresuan në ligjin e shpallur në maj 2019.

## INFORMACIONE TË MËTEJSHME

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

 [jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)

 [@CoE\\_EU\\_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

## KONTAKT

Ekipi i Koordinimit i Instrumentit Horizontal

Zyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Programeve

Këshilli i Evropës

Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France

E-mail: [Horizontal.Facility@coe.int](mailto:Horizontal.Facility@coe.int)

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

**[www.coe.int](http://www.coe.int)**

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t' i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

**[www.europa.eu](http://www.europa.eu)**

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës